




BASHKIA KLOS



RAPORTI I PERFORMANCËS 2019

Statusi raportit: Raporti bazohet në të dhëna të konsoliduara të zbatimit të buxhetit për bashkinë Klos gjatë vitit 2019 "**miratuar në Këshillin Bashkiak**".

Përgatitur nga Bashkia Klos me asistencën e Projektit "**Bashki të Forta**" dhe **Shapo Consulting**. Për më shumë informacion kontaktoni Zj.Silvana Neziri në adresën: Neziri.Silvana@yahoo.com

TË DHËNA TË PËRGGJITHSHME 2019

PROFILI

Popullsia



Census (2011) 16.618 banorë

Regjistri Civil 20.281 banorë

Dendësia



Census (2011) 46 banorë/km²

Regjistri Civil 58,24 banorë/km²



4 njësi administrative

BASHKIA

Kryetari i Bashkisë




Z. Ilmi Hoxha

Këshilli i Bashkisë

Këshilli bashkiak përbëhet nga 21 anëtarë, ku mazhoranca i përket Partisë Socialiste të Shqipërisë së bashku me aleatët .



6



15

EKONOMIA

Degët kryesore të ekonomisë janë bujqësia, ku klima e favorshme lejon kultivimin e të gjitha bimëve e drufrutorëve, blegtoria dhe shërbimet. Klosi është i pasur me burime të shumta natyrore, tokësore dhe nëntokësore. Pyjet dhe kullotat komunale zënë një sipërfaqe të konsiderueshme, ku përveç lëndës drusore, ka edhe mjaft bimë mjekësore.

Një tjetër burim kryesor të ardhurash për banorët e këtij rajoni përbën edhe turizmi malor dhe historik, si dhe industria e mineralit të kromit në minierat private të Cërujës.



Industria



Bujqësia



Zhvillimi i turizmit

LEGJENDË

FAQE INFORMUESE

Nocione dhe mënyra e llogaritjes së disa treguesve të përdorur në këtë raport

- Të Ardhura Buxhetore prej Burimeve të veta tregojnë kapacitetin financiar të bashkisë dhe përfshijnë përveç taksave, tarifave, të ardhurave të tjera nga asetet dhe donacionet edhe të ardhurat e trashëguara nga një vit më parë.
- Të ardhurat nga QQ përfshijnë transferatat e pakushtëzuara të ministrisë së financave, transferatat e kushtëzuara për projekte të caktuara të ministrive të linjës dhe FZSHH si edhe transferatat të qeverisë qendrore për funksione të deleguara apo specifike.
- Programet buxhetore janë ato zëra të shpenzimeve të buxhetit të cilat financojnë funksionet ligjore të bashkisë të cilat janë funksione të veta ose funksione të deleguara nga qeveria qendrore.
- Treguesit kyç financiarë – llogaritja dhe domethënia e tyre:

- Norma e totalit të shpenzimeve ndaj totalit të të ardhurave = Ky raport tregon shpenzimet si një përqindje kundrejt të ardhurave, me pak ndryshime – raporti tregon sesa shpenzon njësi për të ofruar një Lek shërbime publike.
- Norma e të ardhurave nga burimet e veta ndaj totalit të të ardhurave = Tregon qëndrueshmërinë fiskale të njësisë. Kujtojmë që në këtë tregues nuk përfshihen të ardhurat e trashëguara nga viti kaluar. Një raport i lartë është pozitiv për njësinë pasi tregon se njësi nuk mbështetet në burime të jashtme (si transferatat e qeverisë qendrore, grantet etj.)
- Norma e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore ndaj totalit të të ardhurave = tregon kapacitetin fiskal të bashkisë. Një normë e lartë mund të sygjerojë jo vetëm mbledhjen e mirë të detyrimeve fiskale por edhe taksa apo tarifa të larta
- Raporti i të ardhurave faktike nga taksat dhe tarifave vendore ndaj planit të tyre = Një diferencë e madhe ose në rritje midis të ardhurave të arkëtuara dhe atyre të planifikuara përgjatë viteve mund të tregojë një rënie të përgjithshme të ekonomisë vendore. Nëse kjo diferencë bëhet e përheshme atëherë problem është mbledhja e taksave dhe tarifave vendore që mund të jetë për shkak të procedurave, barrës së lartë fiskale, ose parashikim i pasaktë.
- Norma e shpenzimeve për investime kapitale ndaj totalit të shpenzimeve = Një normë e lartë tregon një menaxhim të mirë të financave vendore duke ofruar përmirësime në shërbimet vendore.
- Norma e shpenzimeve për personelin ndaj totalit të shpenzimeve = Rritja e shpenzimeve për personelin mund të tregojë se shpenzimet po rriten më shumë sesa të ardhurat (pasi zakonisht kostot e personelit kanë pjesën më të madhe të shpenzimeve buxhetore të bashkisë).
- Norma e huamarrjes afatgjatë ndaj totalit të të ardhurave = huaja afatgjatë i referohet një periudhe më të madhe sesa një vit. Një raport / normë e ulët tregon se bashkia është e aftë ta paguajë borxhin (principal + interesin) sipas afatit të caktuar, një normë e lartë mund të sygjerojë se bashkisë do ti duhet të ulë ofrimin e shërbimeve për qytetarët në mënyrë që të shlyejë borxhin
- Norma e detyrimeve të vonuara ndaj totalit të të ardhurave = Detyrimet e vonuara janë pagesa që bashkia nuk ia ka bërë të tretëve brenda afateve ligjore (kontrata; fatura të papaguara etj). Një normë e lartë tregon mundësinë financiare të bashkisë nga të ardhurat e saj për të respektuar detyrimet kundrejt të tretëve.
- Norma e shpenzimeve për politikën sociale ndaj totalit të shpenzimeve = Një normë e lartë tregon ndërmarrjen e politikave të reja ose masa në fushën e shërbimeve sociale ose rritje të numrit të përfituesve të këtyre politikave/masave.



Përmirësim



E njëjta situatë



Përkeqësim





Nuk ka informacion

SHPENZIMET BUXHETORE

SHPENZIMET SIPAS PROGRAMEVE

| NË MIJË LEKË | Fakt 2017 | Fakt 2018 | Fakt 2019 | Plan 2019 | 2019 VS 2018 | Fakt VS Plan 2019 |
|---|----------------|----------------|----------------|----------------|--------------|-------------------|
| Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi | 75,186 | 78,168 | 77,588 | 93,707 | 99% | 83% |
| Çështje financiare dhe fiskale | 5,095 | - | | | | |
| Gjendja civile | 3,536 | 2,972 | 2,677 | 2,801 | 90% | 96% |
| Shërbimet e Policisë Vendore | - | - | 2,906 | 2,941 | | 99% |
| Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile | - | - | 19,184 | 19,762 | | 97% |
| Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatoreve | - | - | 2,382 | 2,734 | | 87% |
| Menaxhimi i Infrastruktues së ujitjes dhe kullimit | 16,473 | 18,280 | 13,355 | 21,433 | 73% | 62% |
| Administrimi i pyjeve dhe kullotave | 3,748 | 5,787 | 7,427 | 10,376 | 128% | 72% |
| Rrjeti rrugor rural | 35,228 | 59,327 | 69,048 | 125,788 | 116% | 55% |
| Menaxhimi i mbetjeve | 3,176 | | | | | |
| Menaxhimi i ujrave të zeza dhe kanalizimeve | | | | | | |
| Planifikimi Urban Vendor | | | | | | |
| Sherbime publike vendore | 77,138 | 7,800 | 8,757 | 12,726 | 112% | 69% |
| Furnizimi me ujë | 19,638 | 17,601 | 21,626 | 44,540 | 123% | 49% |
| Ndriçim rrugësh | - | - | - | 700 | | 0% |
| Sport dhe argëtim | 1,265 | 2,707 | 3,406 | 3,700 | 126% | 92% |
| Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore | 686 | 1,612 | 2,869 | 6,279 | 178% | 46% |
| Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor | 75,612 | 28,694 | 30,346 | 37,849 | 106% | 80% |
| Arsimi i mesëm i përgjithshëm | 7,734 | 18,354 | 29,303 | 39,951 | 160% | 73% |
| Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara | 123,000 | | | | | |
| Kujdesi social për familjet dhe fëmijët | 98,478 | 211,097 | 222,145 | 222,145 | 105% | 100% |
| Strehimi social | 570 | 46,164 | 29,122 | 31,557 | 63% | 92% |
| Totali | 546,563 | 512,481 | 547,619 | 684,748 | 107% | 80% |

ILUSTRIM




BURIMET E FINANCIMIT


| BURIMET | | | | | | |
|---|------------------|------------------|------------------|------------------|---------------------|--------------------------|
| NË MIJË LEKË | Fakt 2017 | Fakt 2018 | Fakt 2019 | Plan 2019 | 2019 VS 2018 | Fakt VS Plan 2019 |
| TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA | 25,978 | 31,301 | 42,919 | 136,093 | 137% | 32% |
| Të ardhurat nga taksat lokale | 12,688 | 14,623 | 23,432 | 20,938 | 160% | 112% |
| Të ardhurat nga taksat e ndara | 390 | 2,850 | 352 | 1,500 | 12% | 23% |
| Të ardhurat nga tarifat vendore | 6,483 | 11,432 | 12,145 | 52,338 | 106% | 23% |
| Të ardhura të tjera vendore | 6,417 | 2,396 | 6,990 | 61,317 | 292% | 11% |
| TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR | 503,389 | 469,148 | 433,271 | 433,271 | 92% | 100% |
| Transferta e pakushtëzuar | 126,913 | 131,261 | 134,094 | 134,094 | 102% | 100% |
| Transferta e kushtëzuar | 305,022 | 253,593 | 224,010 | 224,010 | 88% | 100% |
| Për funksionet e deleguara | 234,065 | 190,620 | 213,972 | 213,972 | 112% | 100% |
| Për projekte të veçanta (FZHR dhe të tjera) | 70,957 | 62,973 | 10,038 | 10,038 | 16% | 100% |
| Trasferta specifike | 71,454 | 84,294 | 75,167 | 75,167 | 89% | 100% |
| Trashëgimi nga Viti kaluar | 20,732 | 21,985 | 42,992 | 42,992 | 196% | 100% |
| TOTAL BURIME FINANCIARE | 550,099 | 522,434 | 519,182 | 612,356 | 99% | 85% |

BURIMET E FINANCIMIT NË % NDAJ TOTALIT 2019

Të Ardhura Buxhetore prej Burimeve të veta



Kontributi i Qeverisë Qëndrore



Rritje të burimeve të veta të financimit

37%

Rritje të transfertave të qeverisë

-8%

SHPENZIMET SIPAS PROGRAMEVE BUXHETORE

PROGRAMET NË RAPORT

| PROGRAMET | Raporti kundrejt total 2017 | Raporti kundrejt total 2018 | Raporti kundrejt total 2019 |
|--|-----------------------------|-----------------------------|-----------------------------|
| Kujdesi social për familjet dhe fëmijët | 18% | 41% | 41% |
| Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi | 14% | 15% | 14% |
| Rrjeti rrugor rural | 6% | 12% | 13% |
| Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor. | 14% | 6% | 6% |
| Arsimi i mesëm i përgjithshëm | 1% | 4% | 5% |
| Strehimi social | 0% | 9% | 5% |
| Furnizimi me ujë | 4% | 3% | 4% |
| Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile | 0% | 0% | 4% |
| Menaxhimi i Infrastruktues së ujitjes dhe kullimit | 3% | 4% | 2% |
| Sherbime publike vendore | 14% | 2% | 2% |
| Administrimi i pyjeve dhe kullotave | 1% | 1% | 1% |
| Sport dhe argëtim | 0% | 1% | 1% |
| Shërbimet e Policisë Vendore | 0% | 0% | 1% |
| Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore | 0% | 0% | 1% |
| Gjendja civile | 1% | 1% | 0% |
| Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatorit | 0% | 0% | 0% |
| Çështje financiare dhe fiskale | 1% | 0% | 0% |
| Menaxhimi i mbetjeve | 1% | 0% | 0% |
| Menaxhimi i ujrave të zeza dhe kanalizimeve | 0% | 0% | 0% |
| Planifikimi Urban Vendor | 0% | 0% | 0% |
| Ndriçim rrugësh | 0% | 0% | 0% |
| Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara | 23% | 0% | 0% |

PROGRAMET NË FOKUS TË BASHKISË

41%



*Kujdesi social
per familjet dhe fëmijët*

14%



*Planifikimi Menaxhimi
dhe Administrimi*

13%



*Rrjeti Rrugor
Rural*


6%



*Arsimi bazë përfshirë arsimin
parashkollor*

SHPENZIMET SIPAS KLASIFIKIMIT EKONOMIK


SHPENZIMET SIPAS KLASIFIKIMIT



INVESTIME TË PARASHIKUARA



PROGRAMET MË TË MBËSHETURA ME INVESTIME



INVESTIMET

LISTA EMËRORE E PROJEKTEVE TË INVESTIMEVE


| Projekti | Vlera e plotë projektit | Fillon | Mbaron | Plani I buxhetit 2019 | REALIZIMI PROGRESIV fillimi i projektit deri në periudhën aktuale | % e Realizimit (nga fillimi deri në fund të vitit 2019) |
|---|-------------------------|--------|--------|-----------------------|---|---|
| Kontr. Riparim ne rruge dhe ura ne NJ.Xiber | 4700 | 2018 | 2019 | 4,624 | 4,684 | 100% |
| Rik. I rruges Kalaja Petralb,Rik rruga Gurr e vogel,dhe ndertim ure Lela-Arriku | 15240 | 2018 | 2019 | 13,427 | 11,240 | 74% |
| Ndertim rruge lagja doka-Fshat | | 2019 | 2019 | 132 | | |
| Kol Ndertim akse rruges ne fshatra | | 2019 | 2019 | 68 | | |
| Mbikq. Ndertim muresh ne rruget e Bashkise | | 2019 | 2019 | 41 | | |
| Projekti I rruges Petralbe - Kala | | 2018 | 2019 | 589 | 589 | |
| Projekt Ura metalike Klos | | 2018 | 2019 | 343 | 343 | |
| Projektim rruga e Xiber Murrize | | 2018 | 2019 | 540 | 540 | |
| Kontr. Rikualifikim urban I Qytetit | 11240 | 2018 | 2019 | 4,943 | 11,240 | 100% |
| Ndertime dhe riparime rruges ne Bashkine Klos | | 2019 | 2019 | 10,360 | | |
| rik.rrug,nd.mure ne lagj.Spaval Dars,Bejne dhe Mishter | | 2019 | 2019 | 4,624 | | |
| Projekt ndertim dige ne liq.Balgjaj | | 2019 | 2019 | 294 | | |
| Projekte Nd.dige ne Liqenet Balgjaj | | 2019 | 2019 | 98 | | |
| Projektim rik. Kan.vaditese Fsh.ceruje,fsh.Rripe,fsh.Fsh | | 2019 | 2019 | 1,864 | | |
| Blerje tub per kanalet vaditese | | 2019 | 2019 | 3,963 | | |
| Sherb.dhe miremb.kanale vaditese | | 2019 | 2019 | 3,042 | | |
| Ndertim sifoni Fullqet | | 2019 | 2019 | 1,978 | | |
| Rik.Kanale vaditese ne fshatrat e Bashkise Klos | | 2019 | 2019 | 659 | | |
| Mbik.Ndertim Sifoni Fullqet | | 2019 | 2019 | 29 | | |
| Projekti rikualifikim Urban zona Kodra e Pleshes | | 2019 | 2019 | 245 | | |
| Projektim Ndertim lulishte ne Qytetin Klos | | 2019 | 2019 | 216 | | |
| Kontr. Sistemim asfaltim ne lagjet e qytetit Klos | 11240 | 2018 | 2019 | 3,000 | 6,200 | 55% |

| Projekti | Vlera e plotë projektit | Fillon | Mbaron | Plani I buxhetit 2019 | REALIZIMI PROGRESIV fillimi i projektit deri në periudhën aktuale | % e Realizimit (nga fillimi deri në fund të vitit 2019) |
|---|-------------------------|--------|--------|-----------------------|---|---|
| Ndertim Xhamia Fullqet | | 2019 | 2019 | 479 | | |
| Blerje kontinjeresh mbeturinash | | 2019 | 2019 | 152 | | |
| Projekti ndertim Amfiteatri Kontr. Rikualifikim urban I Qytetit | | 2019 | 2019 | 1,000 | | |
| Projekt utesjellsi lug.Klos Lgj.Dalti-Ura e deges | | 2019 | 2019 | 589 | | |
| Projekt utesjellsi perroit te lopes | | 2019 | 2019 | 784 | | |
| Proktin Ujesjellese Lugina e Klosit Lgj.Dalti - Ura e deges | | 2019 | 2019 | 98 | | |
| Projekti I utesjellesit te perroit te Lopes | | 2019 | 2019 | 98 | | |
| Blerje makine Zjarrfikse | | 2019 | 2019 | 3,850 | | |
| Rikonst.ambjente per sektorin zjarrfikes | | 2019 | 2019 | 312 | | |
| Blerje kompjutera per PMNZH | | 2019 | 2019 | 852 | | |
| Blerje kamion mbi 3.5ton | | 2019 | 2019 | 960 | | |
| F.V.dyer ne sektorin zjarrfikes | | 2019 | 2019 | 400 | | |
| Sistemim ambjente te jashtme tek zjarrfiksj | | 2019 | 2019 | 960 | | |
| Blerje mjete pune per PMNZH | | 2019 | 2019 | 930 | | |
| Projekt KUZ Lgj.shengjun-verbal,fullqet,suç,fshat | | 2019 | 2019 | 687 | | |
| Projekte KUZ ne Lgj.Shenj.-verbar,qender Fullq.,Shk.M.Suç, qend.Fsh.Fshat | | 2019 | 2019 | 883 | | |
| Ndertim kanale te ujrave te zea | | 2019 | 2019 | 2,000 | | |
| Kontr. Rikonstruksion zyra e keshillit | | 2019 | 2019 | 2,000 | | |
| Rikonst.shkolla e mesme Klos | 87857 | 2019 | 2019 | 28,143 | | 0% |
| Sistemim asfaltim rruget e Qytetit Klos | 49834 | 2015 | 2019 | 25,902 | | 0% |
| Kontr.Rik Rruga Dars | | 2019 | 2019 | 3,885 | | |
| Blerje varinsk I vogel | | 2019 | 2019 | 1,700 | | |
| Ndertim muresh ne rrugen Mishter | | 2019 | 2019 | 953 | | |

| Projekti | Vlera e plotë projektit | Fillon | Mbaron | Plani I buxhetit 2019 | REALIZIMI PROGRESIV fillimi i projektit deri në periudhën aktuale | % e Realizimit (nga fillimi deri në fund të vitit 2019) |
|--|-------------------------|--------|--------|-----------------------|---|---|
| Blerje tubacioni (Suç + Xiber) | | 2019 | 2019 | 948 | | |
| Blerje tombina per rikonstruksion rruges | | 2019 | 2019 | 300 | | |
| Rik. Te ndryshme ne ujesjells,kanele,rruge,xhami dhe qytet | | 2018 | 2019 | 1,932 | 1,405 | |
| Rikonstuk.e mirembajtje kanale vaditese | | 2019 | 2019 | 685 | | |
| Blerje pemesh | | 2019 | 2019 | 99 | | |
| Nd.Skulptura e Budit+Skenderbeu | | 2019 | 2019 | 600 | | |
| Ndertim memoriali Zonja Çurre , 17 martiret | | 2019 | 2019 | 566 | | |
| Ndertim kanale te ujrave te zea | | 2019 | 2019 | 419 | | |
| Kontr. Rikonstruksion zyra e keshillit | | 2019 | 2019 | 300 | | |
| Blerje makine per administraten | | 2019 | 2019 | 580 | | |

INVESTIMET


PESHA E INVESTIMEVE SIPAS PROGRAMEVE 2019




TREGUESIT FINANCIAR

TREGUESIT


SITUATA FINANCIARE




Norma e totalit të shpenzimeve ndaj totalit të të ardhurave



Norma e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore ndaj totalit të të ardhurave



Norma e të ardhurave nga burimet e veta ndaj totalit të të ardhurave



PERFORMANCA E PROGRAMEVE BUXHETORE

Bashkia ofron 36 shërbime publike, nga të cilat ka buxhetuar për të financuar nëpërmjet programeve buxhetore përkatëse 29 prej tyre të ndara në 8 funksione të saj ligjore:

1 – ORGANET EKZEKUTIVE DHE LEGJISLATIVE, ÇËSHTJE FINANCIARE E FISKALE, DHE ÇËSHTJET E BRENDSHME

1.1 Planifikim, menaxhim dhe administrim

1.2 Gjendja civile

2 - RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE

2.1 Shërbimet e policisë vendore

2.2 Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile

3 – ÇËSHTJE EKONOMIKE

3.1 Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatoreve

3.2 Menaxhimi i Infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit

3.3 Administrimi i pyjeve dhe kullotave

3.4 Rrjeti rrugor rural + urban

4 – MBROJTJA E MJEDISIT

4.1 Menaxhimi i mbetjeve

4.2 Menaxhimi i ujrave të zeza dhe kanalizimeve

5 – STREHIMI DHE KOMODITETET E KOMUNITETIT

5.1 Planifikimi urban vendor

5.2 Furnizimi me ujë

5.3 Ndrëhim rrugësh

6 – ARGËTIMI, KULTURA DHE FEJA

6.1 Sport dhe argëtim

6.2 Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore

7 – ARSIMI

7.1 Arsimi parashkollor përfshirë arsimin bazë


7.2 Arsimi i mesëm i përgjithshëm

8 – MBROJTJA SOCIALE


8.1 Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara

8.2 Strehimi Social

ORGANET EKZEKUTIVE DHE LEGJISLATIVE, ÇËSHTJE FINANCIARE E FISKALE, DHE ÇËSHTJET E BRENDSHME



PLANIFIKIM, MENAXHIM DHE ADMINISTRIM



01110 - SHPENZIMET E PROGRAMIT

| Shpenzime | Fakt 2017 | Fakt 2018 | Fakt 2019 | Plan 2019 | 2019 vs 2018 | Fakt vs Plan 2019 |
|--------------|---------------|---------------|---------------|---------------|--------------|-------------------|
| Korente | 61,795 | 71,682 | 74,914 | 89,131 | 105% | 84% |
| Kapitale | 13,391 | 6,486 | 2,674 | 4,576 | 41% | 58% |
| Total | 75,186 | 78,168 | 77,588 | 93,707 | 99% | 83% |

QËLLIMI I PROGRAMIT BUXHETOR

Qeverisja vendore e përgjegjëse dhe transparente

OBJEKTIVI I PROGRAMIT

Përmirësimi i stafit të bashkisë

| Performanca | Realizimi Faktik |
|--|------------------|
| Qëndrueshmëria e administratës civile | ↓ |
| Kapacitetet e burimeve njerëzore të bashkisë | ↓ |
| Puna e stafit të bashkisë | = |

PRODUKTET E PROGRAMIT

| | 2018 | 2019 Fakt | 2019 Plan |
|---|------|-----------|-----------|
|  Numri i punonjësve që kanë lëvizur brenda vitit | 15 | 20 | 20 |
|  Numri total i punonjësve | 237 | 238 | 240 |
|  Masa disiplinore të marra nga stafi bashkisë | 10 | 10 | 20 |
|  Totali i ditëve të trajnimeve | 50 | 35 | 40 |
|  Numri total i personave të trajnuar | 20 | 20 | 25 |

Bashkia ka gjithsej 222 punonjës me kohë të plotë pune, nga të cilët punonjës të administratës së bashkisë janë 18.

**238 punonjës
në total**



**70 punonjës
të administratës**

Ky program buxhetor mbështet aktivitetin e përditshëm të personelit të administratës së bashkisë si

- Shërbimet e prokurimit
- Shërbimet statistikore dhe baza e të dhënave vendore
- Mbajtja dhe ruajtja e dokumenteve dhe arkivave të njësisë, ndërtesave në pronësi apo të zëna nga njësia, parqe qendrore automjesh, zyrave të printimit dhe IT etj.
- Prodhim dhe përhapje e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet për zhvillimin e komunitetit.
- Administrim, funksionim dhe ofrimi i shërbimeve të mbështetjes për kryetarin e bashkisë, këshillin dhe komisionet e këshillit ose të kryetarit
- Administrata e bashkisë kontribuon në ofrimin e të gjitha funksioneve të përcaktuara me ligj. Produktet e punës së administratës jepen në programet buxhetore pjesë e këtij raporti performance

TREGUESIT E PERFORMANCËS BUXHETORE

| Matja e Treguesve të Performancës | | 2018 | 2019 Fakt | 2019 |
|-----------------------------------|--|------|-----------|------|
| TP 1. | Numri i punonjësve që kanë lëvizur brenda vitit kundrejt numrit total të punonjësve (raporti në %) | 6% | 8% | 8% |
| TP 2. | Masa disiplinore të marra nga stafi bashkisë (ndryshimi në numër kundrejt vitit të kaluar) | | 0 | 10 |
| TP 3. | Ditë trajnimi për person në vit (mesatarisht) | 2.50 | 1.75 | 1.60 |

Levizja e numrit te punonjëve përgjatë vitit 2019 reflekton vitin zgjedhor



GJËNDJA CIVILE



01170 - SHPENZIMET E PROGRAMIT

| Shpenzime | Fakt 2017 | Fakt 2018 | Fakt 2019 | Plan 2019 | 2019 vs 2018 | Fakt vs Plan 2019 |
|--------------|-----------|-----------|-----------|-----------|--------------|-------------------|
| Korente | 3,536 | 2,972 | 2,677 | 2,801 | -10% | 5% |
| Kapitale | - | - | - | - | - | - |
| Total | 3,536 | 2,972 | 2,677 | 2,801 | -10% | 5% |

QËLLIMI I PROGRAMIT BUXHETOR

Sigurimi i hedhjes, ruajtjes dhe ndryshimit të të përbërësve të gjendjes civile të shtetasve shqiptarë, shtetasve të huaj dhe të personave pa shtetësi, me banim të përkohshëm/të përhershëm në RSH

OBJEKTIVI I PROGRAMIT

Funksionimin efikas dhe eficient i shërbimit të gjendjes civile

Performanca

Realizimi Faktik

Numri dokumentave të prodhuar (në ditë)







Menaxhimi me efikasitet të shërbimit të Gjendjes Civile



Të ardhura të arkëtuara nga prodhimi i dokumentave të ZGJC



PRODUKTET E PROGRAMIT

| | 2018 | 2019 Fakt | 2019 Plan |
|---|-------|-----------|-----------|
|  Numri i dokumentave të prodhuar / lëshuar | 10000 | 9900 | 10100 |
|  Koha në ditë për marrjen e dokumentit nga momenti i aplikimit | 10 | 10 | 10 |
|  Të ardhura të arkëtuara nga prodhimi i dokumentave të prodhuara | 5000 | 5000 | 5050 |
|  Total shpenzime të gjendjes civile në Lekë | 2972 | 2677 | 2936 |




84 PUNONJËS

TREGUESIT E PERFORMANCËS BUXHETORE

| Matja e Treguesve të Performancës | 2018 | 2019 Fakt | 2019 |
|---|------|-----------|------|
| TP 1. Numri i dokumentave të prodhuar (ndryshimi vjetor në %) | | -1% | 2% |
| TP 2. Lekë të arkëtuara në vit nga ZGJC (ndryshimi vjetor në %) | | 0% | 1% |
| TP 3. Shpenzime në Lekë për 1 dokument të prodhuar nga Zyra e Gjendjes Civile (mesatarisht) | 0.30 | 0.27 | 0.29 |

Edhe pse shërbimi i gjendjes civile ofron shërbime on line, zyra e Gjendjes Civile ka prodhuar më shumë dokumenta gjatë vitit 2019 sesa ato gjatë vitit 2018

RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE



SHËRBIMET E POLICISË VENDORE



03140 - SHPENZIMET E PROGRAMIT

| Shpenzime | Fakt 2017 | Fakt 2018 | Fakt 2019 | Plan 2019 | 2019 vs 2018 | Fakt vs Plan 2019 |
|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|--------------|-------------------|
| Korente | - | - | 2,906 | 2,941 | - | 1% |
| Kapitale | - | - | - | - | - | - |
| Total | - | - | 2,906 | 2,941 | - | 1% |

QËLLIMI I PROGRAMIT BUXHETOR

Përmirësimi i sigurisë së komunitetit

OBJEKTIVI I PROGRAMIT

Rritja e shërbimeve bashkiake për sigurinë dhe qetësinë publike në komunitet

Performanca

Punonjësit e policisë bashkiake gëzojnë statusin sipas ligjit



Realizimi Faktik

=

Ky program buxhetor mbështet aktivitetin e përditshëm të personelit të administratës së bashkisë dhe ofrimin e shërbimeve të përgjithshme publike si:

- Sigurimi i mbrojtjes, qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të bashkisë, në përputhje me dispozitat ligjore;
- Ekzekutimi e zbatimi i akteve të nxjerra nga kryetari i bashkisë dhe i vendimeve të këshillit.

PRODUKTET E PROGRAMIT

| | 2018 | 2019 Fakt | 2019 Plan |
|--|------|-----------|-----------|
|  Punonjës me status të oficerit të policisë bashkiake | 0 | | 0 |
| Numri total i punonjësve të policisë bashkiake | 5 | 6 | 6 |
|  Shpenzimet buxhetore për shërbimet e policisë bashkiake | | 2906 | 2941 |
|  ruajtja e qetësisë publike / lokale | 7 | 8 | 10 |
|  etj. për zhurmat | | | |
|  menaxhimi i zënkave (konflikteve) | 4 | 9 | 10 |
|  Numri i rasteve të raportuara nga popullata, etj tek policia bashkia | 64 | 72 | 70 |

4

PUNONJËS ME KOHE TË PLOTË

TREGUESIT E PERFORMANCËS BUXHETORE

| Matja e Treguesve të Performancës | 2018 | 2019 Fakt | 2019 Plan |
|--|------|-----------|-----------|
| TP 1. Raporti midis punonjësve me status të oficerit të policisë bashkiake kundrejt numrit total të punonjësve të policisë bashkiake | 0% | 0% | 0% |
| TP 2. Numri i rasteve problematikave të zgjidhura kundrejt rasteve të raportuara/konstatuara (në %) | | 0% | 0% |

Punonjësit e policisë bashkiake nuk i përmbushin kërkesat e ligjit / oficerë

Policia bashkiake ka nevojë për trajnim të vazhdueshëm për të rritur kapacitetet e punonjësve të saj

MBROJTJA NGA ZJARRI DHE MBROJTJA CIVILE



4%

03280 - SHPENZIMET E PROGRAMIT

| Shpenzime | Fakt 2017 | Fakt 2018 | Fakt 2019 | Plan 2019 | 2019 vs 2018 | Fakt vs Plan 2019 |
|-----------|-----------|-----------|---------------|---------------|--------------|-------------------|
| Korente | - | - | 11,118 | 11,498 | - | 97% |
| Kapitale | - | - | 8,066 | 8,264 | - | 98% |
| Total | - | - | 19,184 | 19,762 | - | 97% |

QËLLIMI I PROGRAMIT BUXHETOR

Përmirësimi i sigurisë së jetës dhe pronës së komunitetit

OBJEKTIVI I PROGRAMIT

Shërbimeve të përmirësuara i ofrohen komunitetit

| Performanca | Realizimi Faktik |
|--|------------------|
| Reagimi ndaj njoftimeve për zjarre | = |
| Ndërhyrjet për shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin | ↓ |
| Efiçencës buxhetore në ofrimin e shërbimit SHMZ | ↓ |

PRODUKTET E PROGRAMIT

| | 2018 | 2019 Fakt | 2019 Plan |
|--|--------|-----------|-----------|
|  Numri i stacioneve të MZSH që ka bashkia | 1 | 1 | 1 |
|  Numri i punonjësve MZSH | 14 | 14 | 14 |
|  Total shpenzime për SHMZ | 16,000 | 19,181 | 19,760 |
|  Numri total i rasteve të menaxhuara | 16 | 15 | 20 |
|  Koha e daljes nga stacioni në sekonda: | | | |
| - natën | 19 | 19 | 19 |
| - ditën | 15 | 15 | 15 |

Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Mbrojtjes Civile e cila menaxhon këtë program ka 14 punonjës me kohë të plotë pune.



14 PUNONJËS

Ky program buxhetor mbështet aktivitetin e përditshëm të personelit të administratës së bashkisë si:

- **Funksionimi i njësive zjarrfikëse dhe i shërbimeve tjera të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit;**
- **Mbrojtja civile dhe administrim i strukturave përkatëse;**
- **Mbështetja e programeve trajnuese të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit;**
- **Shërbimet e mbrojtjes civile, si shpëtimit malore, evakuimi i zonave të përmytura etj.**
- **Shërbime të parandalimit dhe mbrojtjes kundërzjarrit;**

TREGUESIT E PERFORMANCËS BUXHETORE

| Matja e Treguesve të Performancës | | 2018 | 2019 Fakt | 2019 Plan |
|-----------------------------------|---|-----------|-----------|-----------|
| TP 1. | Dalja nga stacioni (ndryshimi në sekonda): | | 0 | 0 |
| TP 2. | Dalja nga stacioni ditën (ndryshimi në sekonda) | | 0 | 0 |
| TP 3. | Dalja nga stacioni natën (ndryshimi në sekonda) | | 0 | 0 |
| TP 4. | Kosto mesatare e një rasti të menaxhuar nga Stacioni MZSH (lekë për një rast) | 1,000,000 | 1,278,733 | 988,000 |
| TP 5. | Numri i rasteve të menaxhuara për shuarjen e zjarrit (ndryshimi vjetor në %) | | -6% | 33% |
| TP 6. | Mbulimi kostove të shërbimit MZSH nga të ardhurat e shërbimit (në %) | | 0% | 0% |
| TP 7. | Numri i rasteve të menaxhuara për shuarjen e zjarrit (ndryshimi vjetor në %) | | -6% | 33% |

Menaxhimi i m w pak rastesh zjarri dhe shpwtimi ka bwrw qw kostoja pwr njw rast tw menaxhur tw rritet

ÇËSHTJET EKONOMIKE



SHËRBIMET BUJQËSORE, INSPEKTIMI,
SIGURIA USHQIMORE DHE MBROJTJA E
KONSUMATORËVE



ADMINISTRIMI I PYJEVE DHE
KULLOTAVE



MENAXHIMI I
INFRASTRUKTURËS SË
UJITJES DHE KULLIMIT



RRJETI RRUGOR RURAL



SHËRBIMET BUJQËSORE, INSPEKTIMI, SIGURIA USHQIMORE DHE MBROJTJA E KONSUMATORËVE



04220 - PROGRAMI

| Shpenzime | Fakt 2017 | Fakt 2018 | Fakt 2019 | Plan 2019 | 2019 vs 2018 | Fakt vs Plan 2019 |
|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|--------------|-------------------|
| Korente | - | - | 2,382 | 2,734 | - | 87% |
| Kapitale | - | - | - | - | - | - |
| Total | - | - | 2,382 | 2,734 | - | 87% |

QËLLIMI I PROGRAMIT BUXHETOR

Rritja e produkteve bujqësore, pyjore, peshkimit dhe gjuetisë

OBJEKTIVI I PROGRAMIT

Bashkia mbështet prodhimin bujqësor nëpërmjet inspektimit

| Performanca | Realizimi Faktik |
|--------------------------------|------------------|
| Regjistrimi i pronës bujqësore | ↓ |
| Siguria e konsumatorëve | = |



PRODUKTET E PROGRAMIT

| | 2018 | 2019 Fakt | 2019 Plan |
|---|-------|-----------|-----------|
|  Numri i rasteve të gjetura / inspektuar të tregtimit të produkteve bujqësore dhe blektorale në vende dhe tregje informale | 6 | 6 | 6 |
|  Numri i çertifikatave të pronësisë të regjistruara | 121 | 118 | 120 |
|  Numër parcelash bujqësore sipas mbulesës bimore në ha | 3,500 | 3,400 | 3,400 |
|  Sipërfaqja e tokës bujqësore në ha | 4,730 | 4,730 | 4,730 |
|  Granteve për mbështetjen e bujqësisë dhe zhvillimit rural (në lekë) | - | - | 2,735 |

Ky program buxnetor mbështet aktivitetin e përditësimit të personelit të administratës së bashkisë si:

- **Ngritja, plotësimi, ruajtja dhe përditësimi i një sistemi informacioni mbi bazë parcele për tokën bujqësore, që të përmbajë informacion për vendndodhjen e saktë, përmasat dhe pronësinë e parcelave.**
- **Informacion i përgjithshëm, dokumentacion teknik dhe statistika për çështjet dhe shërbimet bujqësore;**
- **Administrim dhe mbrojtje e tokave bujqësore dhe të kategorive të tjera të resurseve;**
- **Fondet e pushtetit qendror për funksionin e deleguar të administrimit dhe mbrojtjes së tokës.**
- **Organizim ose mbështetje e shërbimeve për blegtorinë**
- **Administrim i shërbimeve të peshkimit dhe gjuetisë; mbrojtje, shtim dhe shfrytëzim racional të peshkut dhe kafshëve të egra; liçensave të gjuetisë**
- **Krijimi dhe administrimi i skemave vendore të granteve për bujqësinë e zhvillimin rural**
- **Kontrolli ushqimor, mbrojtja e konsumatorit**

TREGUESIT E PERFORMANCËS BUXHETORE

| Matja e Treguesve të Performancës | | 2018 | 2019 Fakt | 2019 Plan |
|-----------------------------------|---|------|-----------|-----------|
| TP 1. | Numri i rasteve të gjetura / inspektuar të tregtimit të produkteve bujqësore dhe blektorale në vende dhe tregje informale (ndryshimi vjetor në numër) | | 0.0 | 0.0 |
| TP 2. | Numri i çertifikatave të pronësisë të rregjistruara (ndryshimi vjetor në numër) | | (3) | 2 |
| TP 3. | Numër parcelash sipas mbulesës bimore në ha (ndryshimi vjetor në ha) | | (100) | |
| TP 4. | Sipërfaqja e tokës bujqësore (ndryshimi vjetor në ha) | | 0 | 0 |

Është ulur ritmi i pajisjes së familjeve fermere me çertifikatë pronësie mbi tokën bujqësore



MENAXHIMI I INFRASTRUKTUËS SË UJITJES DHE KULLIMIT



2%

04240 - SHPENZIMET E PROGRAMIT

| Shpenzime | Fakt 2017 | Fakt 2018 | Fakt 2019 | Plan 2019 | 2019 vs 2018 | Fakt vs Plan 2019 |
|-----------|---------------|---------------|---------------|---------------|--------------|-------------------|
| Korente | 3,144 | 4,070 | 1,822 | 6,441 | 45% | 28% |
| Kapitale | 13,329 | 14,210 | 11,533 | 14,992 | 81% | 77% |
| Total | 16,473 | 18,280 | 13,355 | 21,433 | 73% | 62% |

QËLLIMI I PROGRAMIT BUXHETOR












Rritja e ekonomisë vendore

OBJEKTIVI I PROGRAMIT

Rritja e prodhimit bujqësor

| Performanca | Realizimi Faktik |
|---|------------------|
| Sistemi kullues | ↑ |
| Sistemi vadites | ↓ |
| Perfitues (familje bujqësore) nga shërbimi vaditje-kullim | = |
| Efiçencës financiare e bashkise në menaxhimin e rrjetit të kanaleve vaditëse dhe kulluese | ↑ |

PRODUKTET E PROGRAMIT

| | 2018 | 2019 Fakt | 2019 Plan |
|---|--------|-----------|-----------|
|  Sipërfaqe bujqësore e mbuluar me ujitje (nw ha) | 2,076 | 2,076 | 2,076 |
|  Sipërfaqe bujqësore e mbuluar me kullim (nw ha) | 203 | 203 | 203 |
|  Numri i familjeve përfituese nga shërbimi i ujitjes dhe kullimit | 3,900 | 3,900 | 3,900 |
|  Buxheti i shpenzuar për shërbimin e vaditjes dhe kullimit në lekë | 18,280 | 13,354 | 21,922 |
|  Sistemi kullues në km linear | 77 | 77 | 77 |
|  Sistemi vaditës në km linear | 77 | 77 | 77 |
|  Kanal kullues i pastruar në km | 2 | 3 | 3 |
|  Kanal ujitës i pastruar në km | 3.0 | 2.5 | 4.0 |
|  Rrjetit total i kanaleve ujitëse në km | 74 | 75 | 80 |
|  Sipërfaqe e tokës së kultivuar në ha | 3,500 | 3,400 | 3,400 |
|  Sipërfaqe e tokës bujqësore në ha (fondi bujqësor sipas inventarit) | 4,730 | 4,730 | 4,730 |

Ky pro
së ba


- **Ndërtim ose organizim i sistemeve të kontrollit të përmytjeve, sistemeve të ujitjes dhe kullimit, duke përfshirë grante, hua dhe financime për punime të tilla;**
- **Administrim, shfrytëzim dhe mirëmbajtje e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit nën përgjegjësinë e njërive të vetëqeverisjes vendore**

TREGUESIT E PERFORMANCËS BUXHETORE

| Matja e Treguesve të Performancës | | 2018 | 2019 Fakt | 2019 Plan |
|-----------------------------------|--|---------|-----------|-----------|
| TP 1. | Sipërfaqe bujqësore e mbuluar me vaditje (ndryshimi vjetor në %) | | 0.0% | 0.0% |
| TP 2. | Sipërfaqe bujqësore e mbuluar me kullim (ndryshimi vjetor në %) | | 0% | 0% |
| TP 3. | Familjet bujqësore përfituese të shërbimit vaditje - kullim (ndryshimi vjetor në numër) | | 0.0 | 0.0 |
| TP 4. | Km kanal kullues të pastruar kundrejt rrjetit total të kanaleve kulluese në pronësi të bashkisë (në %) | 3% | 4% | 4% |
| TP 5. | Km kanal vaditës të pastruar kundrejt rrjetit total të kanaleve ujitëse në pronësi të bashkisë (në %) | 4% | 3% | 5% |
| TP 6. | Sipërfaqja e tokës bujqësore e kultivuar në % kundrejt totalit të inventarit të tokës bujqësore | 74% | 72% | 72% |
| TP 7. | Kosto mesatare për 1 km liner kanal vaditës dhe kullues të mirëmbajtur në vit (Leke/km) | 118,701 | 86,714 | 142,351 |

Sistemi vaditës dhe kullues është përmirësuar. Megjithatë vetëm një pjesë e sistemit është operativ.

Bërja operationale e gjithë sistemit vaditës dhe kullues mbetet sfidë për bashkikë.



ADMINISTRIMI I PYJEVE DHE KULLOTAVE



1%

04260 - SHPENZIMET E PROGRAMIT

| Shpenzime | Fakt 2017 | Fakt 2018 | Fakt 2019 | Plan 2019 | 2019 vs 2018 | Fakt vs Plan 2019 |
|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|--------------|-------------------|
| Korente | 3,748 | 5,787 | 7,427 | 10,376 | 128% | 72% |
| Kapitale | - | - | - | - | - | - |
| Total | 3,748 | 5,787 | 7,427 | 10,376 | 128% | 72% |

QËLLIMI I PROGRAMIT BUXHETOR







Rritja e ekonomisë vendore

OBJEKTIVI I PROGRAMIT

Rritja e produkteve nga pyjet dhe kullotat

| Performanca | Realizimi Faktik |
|---|------------------|
| Shtimi i fondit pyjor dhe kullor | = |
| Inspektimit i fondit pyjor dhe kullor | ↑ |
| Eficientia e përdorimit të buxhetit të alokuar për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullor | ↓ |

PRODUKTET E PROGRAMIT


| | 2018 | 2019 Fakt | 2019 Plan |
|--|--------|-----------|-----------|
|  Plan menaxhimi i fondit pyjor dhe kullosor(numur) | 0 | 0 | 0 |
|  Numri i pemëve të reja të shtuara në vit | | | |
|  Numri i kontrolleve dhe inspektimeve të fondit | 150 | 170 | 170 |
|  Sipërfaqe totale e fondit pyjor dhe kullosor në ha | 28,461 | 28,461 | 28,461 |
|  Numri i punonjësve në shërbimin e menaxhimit të fondit pyjor dhe kullosor | 11.0 | 11.0 | 11.0 |
|  Shpenzime për shërbimin e menaxhimit të fondit në lekë | 5,787 | 7,426 | 10,376 |

Ky program buxhetor mbështet aktivitetin e përditshëm të personelit të administratës së bashkisë si:

- Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve pyjore;
- Konservim, zgjerim dhe shfytëzim i racionalizuar i rezervave pyjore;
- Administrim i fondit pyjor dhe kullosor publik;
- Mbikëqyrje dhe disiplinim i operacioneve pyjore dhe dhënie e liçencave për prerje pemësh;
- Shpërndarja e kullotave, duke përfshirë përshtirë menaxhimin e kullotjes;
- Prodhim dhe përhapje e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet pyjore;
- Organizim ose mbështetje për veprimtarinë ripyllëzuese, kontrollin e dëmtuesve dhe sëmundjeve, shërbimet pyjore për luftën kundër zjarrit dhe për parandalimin e zjarrit si dhe ofrimi i shërbimeve për operatorët pyjorë;
- Grante, hua ose financime për të mbështetur veprimtaritë tregtare pyjore;

TREGUESIT E PERFORMANCËS BUXHETORE

